KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e IV-të në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

29 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 5 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha jemi në ditën e 24-të të punës në terren në Procesin e Regjistrimit të Popullsisë dhe çdo gjë është duke funksionuar normalisht. Kemi arritur në shifrën afër 900 mijë qytetarë të regjistruar, ashtu siç ka qenë i parashikuar.

Javën e kaluar një mision i ekspertëve ndërkombëtarë nga UNFPA & UNECE në mbështetje të UNKT-së ka vizituar Kosovën dhe ka pasur takime të ndryshmeme gjithë hierarkinë, si dhe ka vizituar punën me terren, ku dhënë vlerësime shumë pozitive për sa u përket standardeve ndërkombëtare të zbatuara gjatë Regjistrimit në Kosovë.

Tutje, U.d. Kryeshefi Ekzekutiv edhe një herë u bëri thirrje të gjithë qytetarëve që të bëhen pjesë e Regjistrimit si dhe të deklaruarojnë saktë të dhënat e tyre.